

**NË EMER TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, (në objektin e degës së gjykatës në Vushtrri) gjyqtari i vetëm gjykues Avni Mehmeti, me procesmbajtësen Lale Miftari, në çështjen penale ndaj të pandehurit Blerim Muja nga Mitrovica për shkak të veprës penale Vjedhje e rende nga neni 327 par.2 pika 2.7 lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë së Shtetit - Prokuroria Themelore në Mitrovicë, PP.I.nr.81/2015, të datës:25.05.2015. Pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar verbale e publike me datën 21.08.2015 në prezencën e prokurorit në PTH në Mitrovicë, Fetije Bajrami Shala të pandehurit Blerim Muja, mbrojtësit të tij av.Fatmire Braha, të njëjtën ditë publikisht e ka shpallur aktgjykimin dhe ka përpiluar me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**KUNDËR:**

**Blerim Muja**, nga i ati **Musa**, e ëma **Enije**, e gjinisë **Alie**, i lindur me 22.09.1995 në Mitrovicë, ku edhe jeton, rruga "M..." me nr. personal: 12143388608, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, instalues i ngrohjes qendrore, i pamartuar, ka të kryer klasën e nëntë, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i gjykuar si i mitur, ndaj tij zhvillohet procedurë penale për veprë tjetër penale, gjendet nën masën e paraburgim prej dt.25.03.2015,

**SHPALLET FAJTOR**

**SEPSE:**

Me dt.23.03.2015, rreth orës 03:00 në Mitrovicë, në lagjen "Ban" pas marrëveshjes paraprake me të miturin B.P e D.D, të organizuar në grup, me qëllim që vetit t'i sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm kanë hyre në marketin "M..." menaxher i së cilës është Mentor Sahatqiu, në atë mënyrë i mituri B.P. me shufër metalike të armaturës ka thyer drynin e derës së marketit, depërton brenda në market me të miturin D.D, shkojnë te arka dhe nga rafti -dollapi kanë marrë cigare "M...ilboro" të llojeve të ndryshme si: 3 boksa cigare "M...ilboro", një boks të gjatë e dy të shkurta (100 S), 10 pako cigare "M...ilboro Light", 10 pako cigare "M...ilboro" - të bardha e të shkurta, 6 pako "M...ilboro" të gjata 100 S", 5 "M...ilboro" të shkurta dhe një "M...ilboro" e gjatë e hapur, gjithsej në vlerë të përafërte 150 euro, ndërsa i pandehuri Blerim Muja ka kontribuar esencialisht në kryerjen e kësaj veprë penale duke bërë roje jashtë lokalit, derisa të pandehurit tjerë në këtë rast kanë kryer veprën penale.

**-Me këtë në bashkëkryerje ka kryer veprën penale - Vjedhje e rende nga neni 327 par.2 pika 2.7 lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-ës.**

**-Gjykata, duke u bazuar në nenin 7,8,9,10,17,21,41,45,73,74,75,76,83 të KPRK-së, neni 327 par.2 pika 2.7 lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-ës dhe nenin 359,360, 361,365,366 të KPP-se, të pandehurit Blerim Muja i**

**SH Q I P T O N**

**I. DENIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej / një / 1 / vit e /gjashtë / 6 / muaj**, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 25.03.2015 e deri në kohën sa do të gjendet në masën e paraburgimit. Dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit Blerim Muja do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.





## DHE

- II. **DENIM ME GJOBË** ne shume prej /dyqind/ 200 /euro, te cilën gjobe-dënim duhet ta paguaj ne afat prej 15 ditësh e jo me larg se 3/tre/ muaj, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Ne rast se i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën, atëherë dënimi me gjobe do t'i shndërrohet ne dënim me burgim dhe do t'i llogaritet një dite burgim ekuivalent me 20 euro gjobe.
- III. **OBLIGOHET** i pandehuri Blerim Muja që t'i paguaj shpenzimet e procedure penale ose paushallin gjyqësor shumen prej 50 euro, ndërsa shpenzimet e procedurës gjykata dot vendos me aktvendim te veçantë, nëse vërtetohet se janë shkaktuar shpenzime tjera.
- IV. E dëmtuar kompania "Meridian" për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest te rregullt civil.

## Arsyetim

Prokuroria Themelore ne Mitrovice, ka ngritur aktakuze PP.I.nr.81/2015, te datës:25.05.2015, ndaj te pandehurit Blerim Muja nga Mitrovica për shkak të veprës penale Vjedhje e rende nga neni 327 par.2 pika 2.7 lidhur me par.1 pika 1.1 te KPRK-ës.

Gjykata, pasi ka pranuar këtë lëndë penale ka vërtetuar se ne këtë çështje penale kjo gjykate ka kompetence lëndorë dhe territoriale për të gjykuar këtë rast. Gjykata, në këtë çështje penale me dt.21.08.2015 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, i pandehuri Blerim Muja e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale Vjedhje e rende nga neni 327 par.2 pika 2.7 lidhur me par.1 pika 1.1 te KPRK-ës, sipas aktakuzës se P.TH Mitrovicë PP.I.nr.81/2015,te datës:25.05.2015.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë për të pandehurin Blerim Muja, ne mbështetje nenit 248, të Kodit te Procedurës Penale te Kosovës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për te pandehurin.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurit Blerim Muja mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate. Gjykata dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprat penale për te cilat u akuzua e me pas u shpall fajtor e ka vërtetuar ne bazë të fotografive ne vendin e ngjarjes, procesverbalin ne këqyrjen e vendit te ngjarjes dt:24.03.2015, pjesërisht nga deklarata e te dëmtuarit –menagjerit ne kompaninë Meridian - Mentor Sahajku dhënë ne Policin e Kosovës me dt.24.03.2015, pjesërisht nga deklarata e dëshmitareve Beqir Beqiri, Agron Veseli, Valmir Seferdini, deklarata te dhënë ne Policin e Kosovës, pas ndodhjes se këtij rasti. Nga vërtetimet për konfiskimin dhe kthimin e sendeve, nga raporti dhe fotoalbumi i Njësia se Forenzikes – Policia e Kosovës- Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicë, gjithsej 18 foto nga vendi i ngjarjes, nga deklarata e te pandehurit Blerim Muja dhënë ne Policinë e Kosovës pas këtij rasti, nga deklarimet dhe mbrojtja qe kane paraqitur te miturit te përfshirë ne këtë rast B.P dhe D.D. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe vërtetojnë përtej çdo dyshimi se i pandehuri Blerim Muja ka kryer veprën penale për te cilën ishte akuzuar dhe për te cilat u shpall fajtor dhe u dënua nga ana e gjykatës, sipas këtij aktgjykimi.





Gjykata, gjithashtu ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit B. M. është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimin e fajësisë i njëjti e ka bërë pas konsultimit të plote dhe të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se akuza dhe pranimi i fajësisë është mbështetur në prova dhe fakte që përmban kjo lende penale si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri B. M., sipas nenit 248 par.4 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, për veprën penale Vjedhje e rende nga neni 327 par.2 pika 2.7 lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-ës.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit B. M. dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar pa mëdyshje se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat ishte akuzuar.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata për të pandehurin B. M. për veprën penale Vjedhje e rende nga neni 327 par.2 pika 2.7 lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-ës ka aplikuar rrethanat e zbutjes së jashtëzakonshme të dënimit sipas nenit 74 par.3, nenpar.3.6, 3.7,3.9, 3.10, 3.11 të KPRK-së, si dhe nenit 75 të KPRK-se, gjykata ka shqiptuar një dënim me të ulte në minimumin e veçantë ligjor, duke arsyetuar me këto rrethana: se i pandehuri ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale që akuzohet nga fillimi i procedurës penale edhe në seancën e shqyrtimit fillestar, se i pandehuri është i moshës shumë të re veten 19 vjeç, i njëjti ka shprehur keqardhje për ndodhjen e këtij rasti, ka përmjetuar se nuk do t'i përsërisë veprat, se ai ka treguar sjellje korrekte në gjykate, por edhe në raport me palët tjetra, se i pandehuri ka bashkëpunuar me organet e ndjekjes derisa kjo çështje ishte në hetim e sipër ku ai edhe në polici kishte pranuar në tërësi veprën penale. Gjithashtu i pandehuri ka vepruar në bashkëveprim në kryerjen e kësaj vepre penale, por roli i tij ka qenë pak me i vogël, në raport me të pandehurit tjerë në këtë rast, sepse ai ka vepruar se roje, derisa është kryer vepra penale e vjedhjes së rende. Ndërsa në seancën e shqyrtimit fillestar mbrojtja dhe i pandehuri e ka kërkuar që të aplikohen dispozitat e zbutjes së dënimit në raport me të pandehurin, ndërsa prokuror i/ja që e ka përfaqësuar akuzën e ka kundërshtuar këtë propozim. Gjykata si rrethane rënduese ka marrë parasysh faktin se ndaj të pandehurit B. M. janë iniciuar disa raste tjetra penale të natyrës së njëjtë pa predikuar fajësinë, ndërsa vetëm për një rast evidentohet që ka përfunduar në procedurën penale për të mitur sipas rastit PPM.nr: 74/2013, për veprën penale të vjedhjes së rende. Faktin se veprën penale e ka kryer me dashje të plote, ka vepruar në grup, me kontribut të madhe në veprën penale, i përgjegjshëm dhe përgjegjës, me qëllim përfitimi, si dhe faktin se kjo natyrë e veprave penale janë mjaft të shprehura dhe shtojnë pasigurinë tek qytetaret e Kosovës, ndërsa nuk ka gjetur ndonjë rrethane posaçërisht rënduese në raport me të pandehurin. Sa i përket dënimit me gjobe kur është caktuar dhe shqiptuar nga ana e kësaj gjykate për të pandehurin ka vlerësuar kushte dhe mundësinë të pandehurit për ta paguar gjobën. Të gjitha këto rrethana për gjykatën janë bindëse se me një dënim të cilin e ka shqiptuar ndaj të pandehurit B. M. dënim me burgim prej një (1) vit e gjashtë(6) muaj dhe dënim me gjobë 200 euro, me të cilin dënim vlerësojmë se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurin për risocializimin, riedukimin dhe parandalimin që në të ardhmen të mos kryej vepra penale si dhe ky dënim do të ndikoj edhe në raport me persona tjerë që të përmbahen dhe të mos kryejnë vepra penale.



Gjykata, ne procedure penale edhe pse pjesërisht e ka vërtetuar demin e shkaktuar sa i përket sendeve te vjedhura, mirëpo ne pjesë tjera demin material ne lokal dhe demin moral eventual tek pale e dëmtuar, nuk e ka arrite ta vërtetoj. Ndërsa prokuroria nuk e ka bashkëngjit akuzës kërkesën e te dëmtuarit për dënim obligim ligjor ky i prokurorisë. Gjithashtu duke marr parasysh se ne këtë qeshje penale i pandehuri Blin Mehmeti ka vepruar ne bashkëveprim me te miturit B.P dhe D.D, ndaj te cilëve është zhvilluar procedura e veçantë e nga këto arsye gjykata ne procedurë penale nuk ka arrite saktë ta përcaktojë kontributin e secilit ne shkaktimin e demit, ne anën tjetër një pjese e sendeve janë kthyer te dëmtuarve sipas vërtetimit për kthim pa specifikuar vlerën e sendeve te kthyer, nga këto arsye ne procedure penale gjykata nuk ka vendosur për kërkesën pasuroro juridiken ne këtë rast te dëmtuarën e ka udhëzuar ne kontest rregullt civil.

Gjykata nga arsyet e cekura si me lart e bazuar ne nenin.365 te KPP-ës, ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450 të KPP-së.

Lidhur me vazhdimin e masës se paraburgimit u vendos ne përputhje me nenin 367 dhe nenit 187 te KPP-së.

Nga sa u tha me lart u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimit

### **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal**

**P.nr.276/2015, të dt.21.08.2015**

**Procesmbajtësja:**

**Lale Miftari**



**Gjyqtari i vetëm gjykes:**

**Avni Mehmeti**



**KËSHILLË JURIDIKË:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuare e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa, i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA,

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
MITROVICË - MITROVICA

Më  
Dana 29.10. 2015

